

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPLLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Specialist II, Drejtoria e Kontrollit të Terrenit (Kategoria e pagës IV-a).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.34029/1, datë 28.09.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

**Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë Bachelor (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Specialist II ka për detyrë si më poshtë:**

- Specialist II varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Specialist II ka këto detyra kryesore:
  - a. Kontroll të territorit të Bashkisë Tiranë në lidhje me situatën ndërtimore.
  - b. Inspekton në mënyrë të vazhdueshme territorin e Njësisë Administrative në të cilin është caktuar nga Drejtori i Kontrollit të Terrenit dhe Kryeinspektori.
  - c. Trajton ankesat e marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizik dhe juridik. Merr masa për zgjidhjen e tyre.
  - d. Zbaton programin e punës të hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e inspektimit.

**Dokumentat që aplikanti për Specialist II në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë Bachelor, dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);
5. Raport mjeko – ligjor;
6. Dëshmi penaliteti;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 11.11.2022 **ora** 14.00.